

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 21/08/2024
PRIMLJENO
No. No. Br.: 02/361



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 26.07.2024 dhe filloi në ora: 14:00.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, antarët e komisionit: Gentianë Hoti, Arlindë Rudi, Sadik Vrenezi dhe zyra për informim.

Mungon: Hamit Lima (LDK). Veton Zogaj (VV), Rukije Bytyqi (NISMA) me arsye.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!
Hapi mbledhjen e -I- (parë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 4 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes.
Kush ëshë për miratimin e rendit të ditës?
Me vota unanime të 4 anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/878 datë: 24.07.2024, e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e mirënjohjeve "Qytetar nderi" të Komunës së Malishevës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/878 datë: 24.07.2024, e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e mirënjohjeve "Qytetar nderi" të Komunës së Malishevës

Kryesuesi Argjend Thaçi: Bazuar në Ligjin nr.03/L-0/40, Për Vetëqeverisjen Lokale, në Republikën e Kosovës, dhe Statutin e Komunës së Malishevës, kërkojë nga ju, iniciimin e procedurave ligjore për thirrjen e mbledhjes së Komunës së Malishevës, sipas procedurave të lejuara me ligj.

Në lidhje me këtë çështje, për rend dite propozojë që në pajtim me nenin 11 të Statutit të Komunës së Malishevës, të shqyrtohet propozimi im, që kanë të bëjë me ndarjen e mirënjohjeve, të shpallën " Qytetar nderi " të Komunës së Malishevës, personaliteteve të cekur si në vijim:
z.David Carr-anëtar i Këshillit të Shtetit të New York, e.Charles D. Fall-anëtar i Asamblesë së

Shtetit të New York dhe z.Naser Nika-veprimtar i shquar për çështjet shqiptare, në New York.
Pas shqyrtimit dhe miratimi nga ana e Juaj të këtij propozimi, mirënjohjet me rastin e shpalljes
“ *Qytetar Nderi* “ i Komunës së Malishevës, do të ju dhurohen personalisht, në *një mbledhje
tjetër solemne*, e cila planifikohet të mbahet me datë, 01 gusht 2024.
Kush është për miratimin e pikës së parë të rendit të ditës?
Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:14:10.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

